



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-045
Prishtinë, më 15 tetor 2018, në orën 9:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 15 TETOR 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti, Slavko Simiq dhe Mufeta Srbica-Shinik.

Nga grupet parlamentare: Armend Zemaj, Memli Krasniqi, Albulena Haxhiu, Ahmet Isufi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit: Blerand Stavileci, Avni Bytyçi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga EUSR: Blerta Bejtullahu dhe

Nga OSBE: Sanije Berisha.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe gjashtë (6) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës dhe
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme së Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 19, 23, 26 korrik dhe 3, 6 e 19 shtator 2018.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet për shqyrtim në seancë plenare.

Pastaj, Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 18 tetor 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës,*
5. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës,*
6. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Traktatit që themelon komunitetin e transportit,*
7. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-078 për ratifikimin e "Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut në kuadër të Projektit të bashkëpunimit zhvillimor, KSV/019: asistencë teknike në kontekstet e integritet evropian",*

8. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-103 për ratifikimin e ndryshimit dhe plotësimit nr. 1 të Marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian,*
9. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës,*
10. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ministrinë e Mbrojtjes,*
11. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës,*
12. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës,*
13. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,*
14. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,*
15. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar,*
16. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Punës,*
17. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,*
18. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit,*
19. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së,*
20. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pagat në sektorin publik,*
21. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të agjencive të pavarura,*
22. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zyrtarët publikë,*
23. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transmetuesin publik të Kosovës,*
24. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive,*
25. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për kinematografinë,*
26. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta,*
27. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat,*
28. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore,*
29. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L -090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit,*
30. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 Ligji i sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për sport,*
31. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për peticione,*
32. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-049 për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë,*
33. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës,*
34. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërmarrjet sociale,*
35. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Qeverisë për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës për vitin 2017,*

36. *Shqyrtimi i raportit të auditimit të Kompanisë Regjionale të Ujësjellësit “Prishtina” sh. A. për vitin 2017,*
37. *Shqyrtimi i raportit vjetor për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2017,*
38. *Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2017,*
39. *Emërimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës,*
40. *Emërimi i kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik,*
41. *Emërimi i 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor,*
42. *Shkarkimi i z. Shqipërim Pula nga pozita e anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare,*
43. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur për Medie nga radha e komunitetit joshumicë,*
44. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb,*
45. *Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare dhe në atë hetimor,*
46. *Emërimi i një (1) anëtari në Komisionin Hetimor Parlamentar.*

* * *

Gjithashtu, Kryesia lidhur me pikat 43 dhe 44 të lartcekura të rendit të ditës, nxori këto përfundime:

I. P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit që para seancës së radhës më 18 tetor 2018 t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga radhët e komuniteteve joshumicë.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë, si në vijim: GP i Nismës Socialdemokrate (kryetarin); GP i PSD-së (zëvendëskryetarin e parë); GP i Listës serbe (zëvendëskryetarin e dytë); GP i LDK-së (2 anëtarë); GP i PDK-së (2 anëtarë); GP i LVV-së (2 anëtarë); GP i AAK-së (1 anëtar) dhe GP 6+ (1 anëtar).

II. P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit që para seancës së radhës më 18 tetor 2018 t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radha e komunitetit serb.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë, si në vijim: GP 6+ (kryetarin); GP i LDK-së (zëvendëskryetarin e parë dhe 1 anëtar); GP i LVV-së (zëvendëskryetarin e dytë dhe 1 anëtar); GP i PDK-së (2 anëtarë); GP i PSD-së, (1 anëtar); GP i AAK-së (1 anëtar); GP i Listës serbe (1 anëtar) dhe GP i Nismës Socialdemokrate (1 anëtar).

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Nisma Legjislative “Projektligji për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve

Kryesia, pasi e shqyrtoi nismën legjislative për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legjislative “Projektligji për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e shpenzimeve të Kuvendit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

3. Propozimi i deputetit Milaim Zeka, mbështetur edhe nga 5 deputetë për formimin e Komisionit Hetimor në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala

Kryesia lidhur me propozimin e lartshënuar vendosi që për këtë çështje të merret vendimi në mbledhjen e radhës të Kryesisë, si dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare që para mbledhjes së radhës të Kryesisë së Kuvendit t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas propozimit

të deputetit Milaim Zeka, mbështetur edhe nga 5 deputetë tjerë, për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala.

2. Përbërja e komisionit do të jetë me 11 anëtarë: grupet parlamentare të LDK-së, LVV-së dhe PSD-së propozojnë pesë (5) anëtarë, në mesin e tyre propozojnë kryesuesin, si dhe grupet parlamentare të PDK-së, AAK-së, Listës serbe, Nismës Socialdemokrate dhe G 6+ propozojnë gjashtë (6) anëtarë, në mesin e tyre propozojnë zëvendës kryesuesin, sipas propozuesit.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për miratimin e buxhetit të këtij Komisioni

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Buxheti i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në shumën prej 5 000,00 (pesëmijë) euro.

5. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë (6) shtetasve turq për miratimin e buxhetit të këtij Komisioni

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Buxheti i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më datë 29 mars 2018, në shumën prej 12 540,00 (dymbëdhjetëmijë e pesëqind e katërdhjetë) euro.

6. Propozimi i grupeve parlamentare të LDK-së dhe Listës serbe për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryesia, propozimet e grupeve parlamentare të LDK-së dhe Listës serbe për zëvendësimin e deputetëve në komisionet parlamentare, si dhe propozimin e GP të LDK-së për zëvendësimin e kryetares së Komisionit Hetimor Parlamentar, i radhiti në rend të ditë për seancën plenare, e cila do të mbahet të enjten, më 18 tetor 2018.

Ndërsa, për propozimin e GP të LDK-së, për zëvendësimin e zëvendës anëtarit në Delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, mori këtë:

V E N D I M

Deputeti Ismet Beqiri caktohet zëvendës-anëtar në Delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, në vend të deputetit Ilir Deda.

7. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve nga udhëtimi zyrtar në Sofje

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Zenun Pajaziti, Glauk Konjufca dhe Time Kadrijaj u lejohet mbulimi i shpenzimeve të transportit, të akomodimit dhe mëditjet nga Buxheti i Kuvendit, në lidhje me udhëtimin zyrtar të realizuar në Sofje (Bullgari), prej 4 - 6 tetor 2018.

2. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për rezervimin e akomodimit të deputetes Blerta Deliu-Kodra në shumën prej 100,56 euro, në lidhje me anulimin e udhëtimi zyrtar nga pika një (1) e këtij vendimi.

3. Nga Parlamenti Evropian do të rimbursohen shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit vetëm për një (1) natë për pjesëmarrësit nga pika një (1) e këtij vendimi.

8. Kërkesa e Komisionit për Integritet Evropian për lejimin e udhëtimit zyrtar në Austri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Blerta Deliu-Kodra dhe Armend Zemaj u lejohet udhëtimi zyrtar në Vjenë (Austri), prej 18 - 20 nëntor 2018.

9. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë

Kryesia nuk e lejoi udhëtimin zyrtar në Bruksel (Belgjikë), i paraparë të realizohet nga 17 - 19 tetor 2018, për shkak të seancës plenare, e cila është caktuar të mbahet më 18 tetor 2018.

10. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Andorrë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Haxhi Shala, Sami Kurteshi dhe Flora Brovina, u lejohet udhëtimi zyrtar në Andorrë, prej 20 - 24 tetor 2018.

11. Kërkesa e deputetit Korab Sejdiu për lejimin e udhëtimit zyrtar në Zvicër dhe Austri

Kryesia, nuk e lejoi udhëtimin zyrtar të deputetit Korab Sejdiu në Cyrih (Zvicër) dhe në Grac (Austri), i paraparë të realizohet nga 16 deri më 21 tetor 2018, për shkak të seancës plenare, e cila është caktuar të mbahet më 18 tetor 2018.

12. Kërkesa e OJQ-së "TOKA" për pagesën e Qirasë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

OJQ "TOKA" mbështetet financiarisht në shumën prej 2 637,36 euro për mbulimin e shpenzimeve për qiranë, për periudhën tremujore prej 1 tetorit deri më 31 dhjetor 2018, për projektin "DEMOS".

13. Kërkesa e shoqatës për persona të verbër dhe shikim të dëmtuar "Drita Jonë"-Vushtrri për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

OJQ-ja "Shoqata Drita Jonë-Vushtrri" mbështetet financiarisht në shumën prej 1 990,00 euro, për projektin që ka për qëllim pjesëmarrjen e personave të verbër në një pushim 5-ditor në Durrës (Shqipëri).

14. Kërkesa e Qendrës Socio-Edukative "Don Bosko" Prishtinë për mbështetje financiare për vendosjen e shtatores së Shën Terezës në Panama

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

OJQ-ja: "Shoqata Socio-Edukative Don Bosko Prishtinë", me seli në Prishtinë mbështetet financiarisht në shumën prej 4 990,00 euro për realizimin e projektit për vendosjen e shtatores së Shën Terezës në Panama.

15. Kërkesa e drejtorit të Revistës Hylli i Dritës dhe Botimeve Françeskane, z. Viktor Demaj, për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Revista “Hylli i Dritës” dhe Botimet Françeskane, mbështetet financiarisht në shumën prej 2 000,00 euro, për realizimin e botimit të librave nga kjo revistë.

16. Kërkesa e OJQ-së “Venture-UP” për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

OJQ-ja: “Venture-UP”, me seli në Prishtinë, mbështetet financiarisht në shumën prej 4 500,00 euro, për shpenzimet e dizajnit dhe renovimit të hapësirave të punës dhe trajnimeve për aktivitetet e saj.

17. Njoftimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për largim të deputetit Dardan Molliqaj nga ky komision

Kryetari i njoftoi të pranishmit në lidhje me njoftimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për largimin e deputetit Dardan Molliqaj nga ky komision, si dhe për zëvendësimin e tij.

Pastaj, Kryesia e radhiti emërimin e një (1) anëtarit në Komisionin Hetimor Parlamentar në rend të ditë për seancën plenare, e cila do të mbahet të enjten, më 18 tetor 2018.

Gjithashtu, Kryesia lidhur me këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, që para seancës së radhës më 18 tetor 2018, ta propozojë një deputet për anëtar të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë (6) shtetasve turq, në vend të deputetit Dardan Molliqaj.

18. Raporti i Delegacionit të Kuvendit të Kosovës për pjesëmarrjen në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, në Varshavë

Kryesia u njoftua me shkrim nga Delegacioni i Përhershëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s lidhur me pjesëmarrjen e tij në Sesionin

Pranveror të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, të mbajtur në Varshavë (Poloni) nga 25 - 29 maj 2018.

19. Njoftimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me realizimin e dy vizitave zyrtare në Maqedoni

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me realizimin e dy vizitave zyrtare në Maqedoni, më 29 qershor dhe më 27 - 30 korrik 2018.

Pikat shtesë:

1. Kërkesa e Produksionit SKY GROUP sh.p.k për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Produksioni “Sky Group” sh.p.k, mbështetet financiarisht në shumën prej 4 500,00 euro, për realizimin e filmit “SunRise”.

2. Kërkesa e znj. Vlora Hasani për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Znj. Vlora Hasani, nga Prishtina, mbështetet financiarisht në shumën prej 4 990,00 euro për mbulimin e shpenzime të trajtimit shëndetësor të djalit të saj.

3. Kërkesë për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësueseve të mediave lidhur me vizitat zyrtare jashtë vendit të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi i Republikës së Kosovës do t’i mbulojë shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit të përfaqësueseve të mediave të cilat do t’i përcjellin vizitat zyrtare të nivelit të lartë jashtë vendit që do të realizohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

4. Propozim-vendimi në lidhje me vendimin e ministrit të Financave për tarifën e rishikuara për udhëtimet jashtë vendit, nr. 30/2018/datë 19.06.2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Për udhëtim zyrtar jashtë vendit të kryetarit të Kuvendit dhe një (1) staf i Kabinetit të kryetarit si dhe i nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tarifën e fjetjes lejohet pagesa sipas faturës së hotelit, duke përjashtuar shpenzimet për shërbime tjera hoteliere.
2. Për udhëtim zyrtar jashtë vendit të Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në rast se tarifa përkatëse për fjetje nuk e mbulon çmimin e hotelit, lejohet tejkalmi i tarifës përkatëse për fjetje, sipas faturës së hotelit deri në shumën e lejuar për shpenzime ditore, sipas Shtojcës A, Kolona "A" të vendimit të ministrit të Financave, nr. 30/2018, datë 19 qershor 2018.
3. Për udhëtim zyrtar jashtë vendit, të deputetit, të stafit politik dhe të nëpunësit civil, kur të gjitha shpenzimet i bartë organizatori-nikoqiri, pjesa e shpenzimeve të vogla-para xhepi është 30% nga shuma e lejuar për shpenzime ditore, sipas Shtojcës A, Kolona "A" të vendimit të Ministrit të Financave, nr. 30/2018, datë 19 qershor 2018.
4. Shërbimi përkatës i Administratës së Kuvendit, për pikën 2 të këtij vendimi, paraprakisht jep sqarime me shkrim se çmimi i hotelit për akomodim nuk mbulohet sipas tarifës përkatëse të lejuar për fjetje.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Kryesisë së Kuvendit për zbatimin e Tarifave për udhëtime zyrtare jashtë vendit, nr. 06-V-286.
6. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kryesia e Kuvendit, me efekt nga data 23 korrik 2018 për pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi.

5. Kërkesa e Shoqatës së Alpinistëve "Merimangat e Pejës" për mbështetje financiare për financimin e projektit "Shtegu i UÇK-së"

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Shoqata e Alpinistëve "Merimangat e Pejës", mbështetet financiarisht në shumën prej 3,500.00 Euro, për financimin e projektit "Shtegu i UÇK-së".

6. Kërkesë për mbështetje financiare Kongresit të Manastirit

Kryesia, me propozim të Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli, mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi i Republikës së Kosovës e mbështet financiarisht Muzeun e Alfabetit të Kongresit të Manastirit në Manastir (Maqedoni) në shumën prej 3 000 euro.

* * *

Në fund, nënkryetari i Kuvendit, z. Slavko Simiq, tha se është kundër radhitjes së pikave 10, 11 dhe 12 në rend dite për seancë plenare më 18 tetor 2018. Diskutimi i plotë i tij është dhënë në transkript.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 9:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale